


# noi veniamo dall'Albania

storie di vita, leggende, ricette, indirizzi utili...

a cura di Zef Chiaramonte



I venditori di accendini e i lavavetri ai semafori. I venditori di elefanti e le domestiche filippine. I cuochi egiziani e le donne di Capoverde. I marocchini e gli albanesi. I bastoncini cinesi e la moschea. Le treccine di Gullit e le Mille e una Notte. L'Oriente bussa alle porte. Anche a quelle della scuola e della biblioteca..

I "MAPPAMONDI" sono libri per ragazzi che hanno compagni di scuola stranieri. Ma anche libri per ragazzi stranieri che hanno compagni di scuola italiani.



419 N 51

419 N

419

419

419



**I MAPPAMONDI 2**

# Noi veniamo dall'Albania

*storie di vita, leggende, ricette, indirizzi utili*  
a cura di **ZEF G. CHIARAMONTE**



*illustrazioni di* **LEONARDO GUASCO**

 *sinnos*  
*editrice*


Copyright © 1992 **SINNOS Editrice**  
Società Cooperativa a r.l.  
Roma, Viale Etiopia, 18  
Tel. 06/86.01.867  
ISBN — 88-86061-01-3

**ZEF G. CHIARAMONTE**, vive a Palermo ed è direttore della Biblioteca di S. Cristina Gela con Sezione albanologica. Studioso dell'Europa orientale, ha curato gli studi albanesi con soggiorni presso l'Università del Kosovo in Prishtina. Durante le ultime immigrazioni di albanesi è stato interprete della Prefettura di Palermo per il campo-profughi di Buonfornello.

**LA LINGUA** - La lingua albanese, appartenente al ceppo indoeuropeo, è basata su un fondo originario illirico, arricchito, nel tempo, da elementi latini, greci, slavi, turchi e italiani.

La lingua ufficiale odierna, pur basata sul *tosco*, è la risultante delle lingue letterarie usate precedentemente dagli scrittori del nord (*ghego*) e del sud (*tosco*).

Particolare interesse rivestono le **parlate** degli antichi Albanesi in Italia (*arbëreshë*) e in Grecia (*arbërorë-arvanitë*).



*ai miei genitori  
ai sacerdoti graeci ritus  
ai professori dell'Università di Prishtina*

*Ringrazio vivamente la dr. Concetta Mineo  
e il prof. Zef Schirò per i loro utili consigli*

**1ª Parte**

# *Le storie di Troka Tiri e Giulio*




## la storia di Troka

*in cerca di fortuna*

**M**i chiamo Troka e sono nato a Tapi, in Albania, trentotto anni fa. Lavoravo in una cooperativa dello Stato: ogni mattina guidavo il carro a due cavalli e consegnavo 10 o 20 quintali di frutta e verdura al mercato di Kuçov.

Avevo una casa costruita con le mie mani dove abitavo insieme a mia moglie. Avevo un fazzoletto di terra, 2 mucche e qualche agnello. Insomma non stavo male, rispetto a molti altri.



## historia e Trokës

*duke kërkuar fatin*

**Q**uëm Troka edhe kam lindur në Tapi të Shqipërisë para tridhjetë e tetë vjet. Në Shqipëri kam punuar në një kooperativë shtetërore: çdo mëngjes me karrocë dykuajshe transportoja 10 ose 20 kuintalë pemë dhe perime në tregun e Kuçovës.

Kisha një shtëpi të bërë me duart e mia ku banoja me nusen. Kisha edhe dy dyllimë tokë, dy lopë e do qengja. Si përfundim nuk isha keq në krahasim me shumë të tjerë.

Atëherë pse ke ardhur në Itali? Do të thoni ju.

Sepse kam pasur dëshirë ta njoh botën e të kërkoj fat më të mirë. Italia, siç e shikonim ne në televizion — atje në Shqipëri kapen kanalet e TV suaj — na paraqitej si bahçe me lule.

E pastaj *xhaxhi Enver* nuk na linte të lidhim dhjamë: aq sa ishte rroga po aq të nevojitej vetëm për të ngrënë.

Allora perché sei venuto in Italia? direte voi. Perché volevo conoscere il mondo e cercare fortuna. L'Italia, dalle immagini che vedevamo alla televisione — là in Albania si prendono i canali della vostra tivù — ci sembrava un paese fortunatissimo.

E poi lo zio *Enver* non ci lasciava mettere i soldi da parte: quello che guadagnavi ti bastava appena per mangiare.

### *il viaggio in Italia*

**I**l viaggio in Italia cominciò così: nel mese di marzo del 1991 si era sparsa la voce che i militari lasciavano scappar via chi voleva, e anche i militari scappavano verso l'Italia per non essere costretti a sparare sulla folla. Io pensai che quella era l'occasione buona e senza dire niente a mia moglie, ai due figli e a mio padre, decisi di partire. Arrivai, un po' a piedi, un po' sopra dei carri, fino al porto di Durazzo. Salii sulla nave *Panamense* strapiena di gente: bambini, donne, uomini, stipati come sardine. Senza cibo né acqua!

Siamo arrivati a Brindisi, in Italia, ed era quasi notte. I bambini sono stati ospitati nelle scuole della città insieme alle loro madri. Noi uomini invece abbiamo dormito al porto e come coperta avevamo dei sacchi

### *udhëtimi për në Itali*

**A**rdhja në Itali filloi kështu: në marsin e 1991 u hap fjala që ushtarët linin të iknin kush të donte, vetë ushtarët po iknin për në Itali që të mos ishin të shtrënguar të shtinin mbi turmën. Unë mendova që ai ishte rasti i favorshëm dhe pa u thënë gjë as nuses as dy fëmijve e as plakut, vendosa të nisem. Ca me këmbë e ca me qerre arrita deri te porti i Durrësit. Hipa anijes *Panameze*, plot e përplot me njerëz: fëmijë, gra, burra të shtypur si rrush. Pa ushqim e pa ujë!

Mbërritëm në Brindizi të Italisë natën. Fëmijët i morën nëpër shkollat e qytetit së bashku me nënat.

Ne burrat u vendosëm në liman e si mbulesë kemi përdorur plastmasë. Popullata e Puljes ka qenë mikpritëse ndaj nesh.

Në mbasdite të 9 marsit policia italiane filloi të na ndante për të na vendosur në vise të ndryshme të Italisë.


Mua më qëlloi që të shkoja me kontingjentin që duhej vendosur në Sicili: ishim 1.500!

Na ngjitën mbi autobusë luksuozë dhe udhëtuam tërë natën në rrugë ëndrrash, ato që italianët i quajnë "autostrade".

di plastica. La gente della Puglia è stata gentile con noi.

Il pomeriggio del 9 marzo la polizia ha cominciato a dividerci per mandarci in diverse parti d'Italia. Sono capitato nel gruppo che doveva andare in Sicilia: eravamo in 1.500!

Ci hanno fatto salire su bellissimi pullman e abbiamo viaggiato una notte intera su strade da favola, quelle che gli italiani chiamano autostrade.



Siamo arrivati in località Buonfornello, a 50 km da Palermo, non lontano da Piana degli Albanesi.

Lì era stato allestito un centro di ospitalità nel quale abbiamo ricevuto alloggio, cibo e vestiario, ma anche documenti personali, libretto di lavoro e scheda sanitaria. Il campo è durato 100 giorni ed è stato il miglior campo per albanesi in Italia.

Mbërritëm në lokalitetin "Buonfornello", 50 kilometra prej Palermo-s, jo fort larg nga Hora e Arbëreshëvet.

Aty kishin ngritur një qendër imigrimi ku kemi gëzuar ushqim, banim e veshmbathje, po ku na kanë pajisur edhe me dokumente njoftimi, librezë pune e dëftesë mjekësore. Kampi zgjati 100 ditë edhe dolli kampi më i mirë për shqiptarë në Itali.

### **si të humbasësh një televizion-kolor dhe të fitosh specia shqiptarë**

**U**në kam fituar edhe disa të holla si përgjegjës pastrimi të banjove në kamp, këtë punë askush nuk pranonte ta bënte. Me anë të të hollave të fituara, bleva menjëherë një frigorifer dhe një TV-kolor e ja dërgova sime shoqeje.

Kaq ishte e domosdoshme dhe lipsej ta bëja! Për t'u treguar nuses dhe gjitonisë që nuk i kisha harruar as familjen as vendlindjen dhe se s'kam ardhur në Itali për zbavitje!

Për fat të keq malli nuk arriti dot në Shqipëri, ma vodhën në Budapest, dhe nusja e mjerë, ndërkohë, kishte shitur televizionin e vjetër bardh e zi. E sigurtë që do të merrte të riun, siç e kisha lajmëruar

***come perdere una televisione a colori  
e trovare dei peperoni albanesi***

**I**o ho anche guadagnato dei soldi come addetto ai servizi igienici del campo, lavoro che nessuno voleva fare. Con i soldi guadagnati ho comprato subito un frigorifero e una TV a colori che ho spedito a mia moglie. Questo andava fatto, lo dovevo fare! Per dimostrare a mia moglie e al vicinato che non avevo dimenticato la famiglia e il paese. E che non ero in Italia per divertirmi!

Purtroppo la merce non è mai arrivata in Albania, è stata rubata a Budapest, e mia moglie, poverina, ha già venduto la nostra vecchia TV in bianco e nero.

Sicura di ricevere quella nuova, come le avevo detto per telefono, ha pensato di mettersi in commercio!

Subito dopo il campo ho lavorato in una azienda agricola, mentre ora lavoro in un'impresa di costruzioni. Nel tempo libero ho potato gli alberi di olivo della zona e coltivo anche un orto. Adesso sto seminando un tipo di peperone che non esiste in Italia. Sicuro, è un peperone albanese!

Se passate da queste parti nel mese di luglio ve lo faccio assaggiare. L'orto sta a Santa Cristina Gela (Palermo).

unë me telefon, kishte menduar të hapte treg!

Fill mbas kampit punova ca kohë në një pronë private, kurse tashti jam në marrëdhënie pune te një ndërmarrje ndërtimore, por në kohën e lirë kam bërë krasitje ullinjësh të vendit e kam vënë edhe një kopsht. Këto ditët e fundit jam duke mbjellë një lloj speci prej të cilit në Itali nuk ka. Patjetër, është një spec shqiptar!

Në se kaloni këndej aty nga korriku do ta shijoni. Kopshti gjendet në Sëndahstinë (Palermo).



## la storia di Tiri

### il porto di Bari

**M**i chiamo Tiri e ho sette anni. Sono arrivato in Italia alcuni mesi fa insieme a mia madre e a mio fratello Olsi, che è più grande di me, con una nave partita da Durazzo.

Mio padre era venuto in Italia due anni prima di noi e ci aspettava al porto di Bari. Il porto di Bari è bellissimo, ho visto le navi più grandi del mondo.

Mio padre era stato portato insieme ad altri suoi compagni di viaggio nel paese di Piana degli Albanesi, in Sicilia.

Lì c'è una comunità antica. Sono albanesi venuti cinque secoli prima di noi, che hanno lasciato la patria a causa dell'invasione dei Turchi.

Dopo, papà, ha cercato di andare in Germania ma poi ha fatto ritorno in Sicilia, a Santa Cristina Gela, dove ha trovato lavoro in un ristorante.


## historia e Tirit

### limani i Barit

**U**në quhem Tiri (Sotiri) dhe jam shtatë vjeç. Mbërrita në Itali disa muaj më para bashkë me nënën e me tim vëlla Olsin, pak më i madh nga unë, me një anije që u nis nga Durrësi.

Baba kishte ardhur në Itali dy vjet para nesh dhe na priste te porti i Barit. Limani i Barit është shumë i bukur, aty kam parë anijet më të mëdha në botë.

Babën tim, së bashku me shokë të tjere udhëtimi, e kishin vendosur në qytezën e Horës së Arbëreshëvet, në Sicili. Aty banojnë një popullsi antike.



## la scoperta della pizza

**V**ado alla scuola elementare per imparare l'italiano ma non sono "iscritto", sono "ospite".

L'anno prossimo mi iscriverò regolarmente.

Nel paese dove vivo si parla l'"arbëresh", che è un dialetto albanese antico, ma si parla anche l'italiano.

Mi piace molto la cucina italiana soprattutto la pizza, che io non conoscevo.



La pizza l'ho scoperta così: la sera del nostro arrivo a S. Cristina Gela mio padre doveva lavorare al ristorante che si trova fuori dal paese. Allora un suo amico arbë-

Janë shqiptarë (arbëreshë) të ardhur pesë shekuj para nesh, të cilët e kanë braktisur atdheun për shkak të dyndjeve të Osmanllive. Pastaj baba u mundua të shkonte në Gjermani, por u kthye edhe një herë në Sicili, pikërisht në Sëndahstinë, ku ka gjetur punë në restorant.

## zbulimi i pices

**U**në shkoj në shkollë për të përvetësuar italishten por nuk jam i "rregullt", jam "mysafir".

Vitin e ardhshëm do të regjistrohem sipas rregullave. Edhe im vëlla do të shkojë në shkollë.

Në vendin ku po jetoj flasin "arbërisht", që do të thotë një të folme shqiptare antike, por flasin edhe gjuhën italiane.

Unë gjellen italiane e pëlqej shumë sidomos "la pica", të cilën s'e dija fare.

Picen e zbulova kështu: atë mbrëmje kur mbërrita në Sëndahstinë, baba ka qenë i dëtyruar të punonte në restorant, restoranti gjendet jashtë vendbanimit. Atëherë një mik i babës na përcolli deri atje me veturë. Unë dhe vëllai nuk i kishim hipur kurrë ndonjë veturë!

Ramë në akord që të shijonim picen. Ishte për ne një emër i çuditshëm dhe i


*resh* ci ha accompagnato là, in macchina. Io e mio fratello non eravamo mai saliti su una macchina!

Scegliemmo di mangiare la pizza. Era un nome strano e nuovo per noi e l'amico di nostro padre non riusciva a tradurlo in albanese anche se conosce molto bene la lingua standard.

Un'altra novità è stata la pastasciutta. Noi non siamo abituati perché la pasta la usiamo quasi soltanto nella minestra e il nostro problema sono soprattutto gli spaghetti perché non sappiamo come si girano con la forchetta.

Io e Olsi ci mettiamo a bocca aperta verso l'alto e facciamo scendere uno spaghetti per volta, anche con le mani.

L'amico di mio padre dice che ci abitueremo presto, perché il problema degli spaghetti ce l'avevano anche gli adulti del campo immigrati.



padëgjuar edhe miku i babës s'ia arrinte dot të na e përkthente shqip, ndonëse e zotëron bukur mirë gjuhën letrare.

Një risi tjetër paska qenë "pastashuta". Ne nuk e dinim sepse makaronat i përdorim vetëm për çorbë dhe pikërisht "spagetat" i kemi problem: nuk dimë si t'i rrotullojmë me pirun.

Unë dhe Olsi hapim gojën për së larti dhe i varim spagetat një nga herë edhe me duar.

Miku i babës pohon se do të mësohemi shpejt, sepse të njëjtin problem e patën edhe të rriturit në kampin e imigratëve.

## la storia di Giulio

*un nonno ritrovato*

**I**o mi chiamo Giulio. Sono nato a Scutari in Albania e sono venuto in Italia con i miei genitori e mia sorella. Ho sette anni e mezzo.

Non sapevo che in Italia, a Palermo, c'era mio nonno. L'ho saputo soltanto quando stavamo sull'aereo. Papà dice che mio nonno era contro il comunismo e nel '49 era fuggito in Grecia e poi in Italia.



## historia e Xhuljo-s

*gjyshi i gjetur*

**U**në jam Xhuljo. Kam lindur në Shkodër të Shqipërisë dhe u nisa për në Itali me prindërit e mi e me motrën. Jam shtatë vjeç e gjysëm.

Nuk isha në dijeni që në Itali, në Palermo, banonte gjyshi. E mësova vetëm kur isha në aeroplan. Baba thotë se gjyshi im ka qenë antikomunist dhe se në '49 u arratis në Greqi e më vonë në Itali.

Gjyshi e flet shumë mirë shqipen. Ai jeton ca kohë në Palermo e ca në Romë ku drejton programin shqiptar të Radio Vatikanit.

*“shiptar i keq!”*

**N**e sot po banojmë në Bageria, në rrethin e Palermos.

Im atë quhet Pjerin e merret me zdukthëtar, ndonëse me profesion është elektroteknik. Jemi në pritje të vizës për të shkuar në Kanada, ku jeton vëllai i gjyshit.

Mio nonno parla benissimo l'albanese. Lui vive un po' a Palermo e un po' a Roma dove è direttore del programma albanese della Radio Vaticana.

**“brutto albanese!”**

**N**oi adesso abitiamo a Bagheria, in provincia di Palermo.

Mio padre si chiama Pierino e fa il falegname, anche se di professione è elettrotecnico.

Stiamo aspettando il visto consolare per andare in Canada dove c'è il fratello di mio nonno.

Intanto vado a scuola a Bagheria e mi trovo bene. Però un giorno un compagno di classe mi ha detto: «Brutto albanese!». Io non ho risposto ma l'ho detto a *mamma\**. La *mamma* mi ha detto che avrei dovuto rispondere subito: «E tu sei un brutto siciliano!».


Il giorno dopo *mamma* mi ha accompagnato a scuola e ha parlato con la maestra.

(\*) “Mamma”: è la seconda moglie del nonno che Giulio chiama “mamma” in italiano, mentre chiama “nënë”, che in albanese significa mamma, la propria madre.

Ndërkohë shkoj në shkollë në Bagheria e jam mirë.

Por një ditë një shok klase me tha: «Brutto albaneze! Shqiptar i keq!». Unë s'u përgjigja por ia tregova *mamës\**. *Mama* më tha që ka qenë e rastit t'i përgjigjesha menjëherë: «E tu sei un brutto siciliano! E ti je një sicilian i keq!».

Të nesërmen *mama* më përcolli në shkollë e foli me mësuesen.



(\*) “Mama”: është nusja e dytë e gjyshit, të cilën Xhuljo e cilëson “mamma”, që italisht do të thotë nënë, kurse normalisht quan “nënë” nënën e vet.

2ª Parte

Leggende  
aneddoti  
canzoni



## **il canto dell'esule\***

*Oh bella Morea,  
da quanto ti lasciai  
più non t'ho rivista  
da quando ti lasciai  
da quando ti lasciai  
da quando ti lasciai  
più non t'ho rivista*

*Lì ho io il signore mio padre  
lì ho io la signora mia madre  
lì ho anche mio fratello  
lì ho  
lì ho  
lì ho anche mio fratello*

*Oh bella Morea,  
da quando ti lasciai  
più non t'ho rivista  
da quando ti lasciai  
da quando ti lasciai  
da quando ti lasciai  
più non t'ho rivista*

*Oh bella Morea...*

*(\*) Canto tradizionale, con qualche variante, in tutte le colonie albanesi d'Italia. Morea è il nome medievale del Peloponneso, regione di provenienza degli Albanesi/Coronei (inizi del 1500)*

## **kënga e mërgimit\***

*Oj e bukura More  
si të lash  
e më ngë të pash  
si të lash  
si të lash  
si të lash  
e më ngë të pash*

*Atje kam u zotin tatë  
atje kam u zonjën mëmë  
atje kam edhe tim vëlla  
atje kam  
atje kam  
atje kam edhe tim vëlla*

*Oj e bukura More  
si të lash  
e më ngë të pash  
si të lash  
si të lash  
si të lash  
e më ngë të pash*

*Oj e bukura More...*

*(\*) Kjo këngë, me variante pak të ndryshme, është një pjesë e traditës kombëtare të të gjitha kolonitë arbëreshe të Italisë. Morea i përgjigjiet emërtimit mesjetar të Peloponezitet, nga u nisën arbëreshët të ashtuquajtur "koronei" (fillimi i sh. XVI).*


## la zucca e la pera\*

**D**'estate, quando la messe è matura e rigogliosa, un tale parte e va al campo ad ammirare il granturco. Dopo aver girato si siede all'ombra di un pero a riposare. Accende una sigaretta e vicino a sé scorge una grossa zucca venuta su da un esile tralcio.

Mentre riposa guarda in alto e vede le pere. Si ferma a pensare e dice tra sé: «Com'è possibile che da un tralcio così fine venga su una zucca così grossa, mentre da un grosso albero di pero un frutto così piccolo! Meglio sarebbe stato che la zucca venisse fuori dal tronco del pero e la pera dal tralcio della zucca».

Mentre stava così a pensare, si stacca una pera e gli cade in testa. Gli fece un po' male e allora disse tra sé: «Quanto l'ha saputa bene colui che ha stabilito le cose così, ché se la zucca fosse stata in alto e mi fosse caduta in testa, mi avrebbe fatto secco sul posto».

(\*) Il testo presenta una delle parlate albanesi del Kosovo, appartenenti al dialetto "ghego". È tratto da: Anton Çetta, Anekdotë I-II, Prishtinë, 1987-88



## kungulli e dardha\*

**N**i ver ish kan ba bereqeti fort. Çohet njani e shkon në arë me e kqyr kallamoqin dhe tu shetit unqjet ner ni hije te ni dardhe me pushu.

E dhezi ni cigare dhe ngat veti po e sheh ni kungull t'madh qi ish rritë pej ni loze t'hollë. Tu nejt po kqyr nalt e po i sheh dardhat. U nal e po menohet dhe po thot me veti: «Qysh asht met pej kësaj loze kaq t'holl mu ba gjith ky kungull, kurse pej gjith këti trupi të dardhes, pema kaq e vogel. Ma mirë u kanë kungulli m'u ba në trup të dardhes, e pema në lozë të kungullit».

Tu menu kështu u këput ni dardh e i ra në krye. I dhimti kryet pak dhe tha me vete: «Sa mirë e ka ditë ai qi e ka lan kështu, se me pas kanë kungulli nalt e me m'ra në krye, um kish myt n'ven».

(\*) Teksti paraqes një nga të folmet shqiptare të Kosovës, Morinë, që i takojnë gegënishtes. Është nxjerrë nga: Anton Çetta, Anekdotë I-II, Prishtinë, 1987-1988.

## la giara piena di monete\*

C'era un vecchio che aveva tre figli. I figli erano abbastanza pigri. Il padre li spingeva a fare qualcosa. Ma essi niente.

Il vecchio aveva una vigna, ma la vigna, senza cura, non fruttava.

Un giorno egli dice ai figli:

— Ragazzi miei, sto per morire, però voglio dirvi una cosa.

— Cosa babbo?

Chiesero i figli.



## qypi me para në vresht\*

**I**sh një plak e i kish tre djem. Djemtë ishin pak si dembelë. Plaku i urdhëron të punojnë diçka, por ata hiç.

Plaku kish një vresht, mirëpo vreshti pa kujdes nuk prodhonte.

Një ditë prej ditësh ai u tha djemve:

— Djemtë e mi, jam në prag vdekjeje, prandaj kam për t'ju kallëzuar diçka.

— Çka, babë? thanë djemtë.

— Nën vresht kam fshehur një qyp me para. Në qoftë se do të shkoni ta kërkoni ju patjetër do të rroni.

U çuan djemtë, i kapën tarrakopat e shkuan në vresht.

Pasi mbërritën po gropojnë thellë për atë qyp me para.

Mirëpo nuk e gjetën. U kthyen te plaku e i thanë:

— Babë, nuk arritim dot ta gjejmë qypin.

— S'ka gjë, dikur do ta gjeni.

Atë vit vreshti bëri shumë mirë se ishte punuar thellë. Djemtë çuan rrushin në pazar dhe e shitën. Bënë para boll e nisën

— Nella vigna ho sotterrato una giara piena di monete. Se volete andare a scovarla certamente avrete di che vivere.

Saltano su i figli, prendono gli arnesi e vanno alla vigna.

Appena giunti scavano in profondità per trovare la giara con le monete.

Però non riescono a trovarla. Tornano dal padre e gli dicono:

— Babbo, non siamo riusciti a trovare la giara.

— Non fa niente, prima o poi la troverete.

Quell'anno la vigna produsse tantissimo perché era stata lavorata a fondo. I figli portarono l'uva al mercato e la vendettero. Guadagnarono molto denaro e cominciarono a migliorare la loro posizione economica. Una sera, seduti nella sala, uno dei figli dice:

— Oh babbo, cosa dobbiamo fare? Non siamo riusciti a trovare quella giara!

— Eh, figlio caro, la giara con le monete è il frutto che ci ha dato la vigna. Perché se non fosse stata dissodata a quel modo, mai avremmo potuto cavarci un soldo. Perciò, se la lavoreremo così anche per l'avvenire, avremo sempre del denaro.

Da quel momento in poi essi si dedicarono al lavoro e divennero laboriosi.

ta përmirësojnë gjendjen e tyre. Një mbrëmje, duke ndenjurr në odë, po flet njëri djalë:

— He, more babë, çë të bëjmë si s'jemi të zotët ta gjejmë atë qyp!?

— Po, bre bir, ja qypi me para: është fryti që na dha vreshti. Se mos ta kishit punuar ashtu, kurrë s'mund ta merrnim një grosh. Prandaj në e punofshim edhe në të ardhme kësisoj, gjithmonë do të kemi para.

Prej asaj here e mbas ata iu përveshën punës e u bënë punëtorë.





## la favola della vecchia\*

**C**'era una volta una vecchia che aveva un soldo. Non sapeva cosa comprare:  
— Se compro l'olio mi cade la goccia, se compro il pane mi cade la briciola...

Alla fine disse:

— Ora compro il latte.

E lo comprò.

Lo mise sul fuoco a cuocere, quando suonò la campana della chiesa. Mise il latte da parte, compose la mantellina in testa e andò a messa.

Al ritorno si accorse che un topo le aveva bevuto tutto il latte e stava per succhiare l'ultima goccia.

Piano piano, prese il mattarello e lo lanciò: lo prese alla coda e gliela spezzò. Il topo — ziu ziu — fuggì e si nascose in un buco del muro.

Qualche tempo dopo il topo si fidanzò, ma la fidanzata non lo voleva sposare senza coda.

Il topo si chiese

Come farò!?

## përralla e plakës\*

**N**jë herë e një herë ish një plakë që kish një sort. Ngë dij që ki' t' blij se thoshëj:  
— Në ble vajt më bie pika, në ble bukën më bie drudhja...

Pra tha:

— Nani ble klëmshit.

E e bleu. E vuri mbi zjarr t'e ziej, kur gjithnjëherje i ra kambana e klisë. Vuri klëmshit minjanë, shtroi mandilinën mi krie e vate te mesha.

Kur u pruar pa se një mi i kish pirë klëmshit e ish e thithëj të sprasmen pikë.

Dal' e dalë, mori drugën e ja ksiti: ja zuri te bishti e ja këputi. Miu — ciu ciu — rrodhi e u fsheh te vëra e murit.

Mbi qrò miu u bë dhëndërr, ma nusja ngë dej t'e martoj pa bisht.

Miu tha:

— E si ka bunje?

Vate te plaka e i tha:

— Plakë, plakë, plakë... m'e jep bishtin?

Se ka' t'e ngjinj e ka' vete martonem.

Ju përgjegj plaka:

— E ti m'e jep klëmshit?

Andò dalla vecchia e le disse:

— O vecchia, me la dai la coda? La devo riattaccare per potermi sposare.

E la vecchia rispose:

— E tu me lo dai il latte?

— Come posso fare?

— Vai dalla capra.

Va il topo dalla capra e le dice:

— O capra, me lo dai un po' di latte? Il latte devo darlo alla vecchia, la vecchia mi deve dare la coda, la coda la devo attaccare e devo andare a sposarmi.



E la capra:

— E tu me la dai un po' d'erba?

— Dove posso andare?

— Al prato.

Va il topo dal prato e gli fa:

— O prato, me la dai un po' d'erba?

L'erba devo darla alla capra, la capra mi deve dare il latte, il latte lo devo dare alla vecchia, la vecchia mi deve dare la coda,

— E si mënt bunj?

— Jec te dhia.

Miu vate te dhia e i tha:

— Dhi, dhi, dhi... m'e jep ca klëmsh?  
Klëmshit ka' ja jap plakës, plaka ka' më japje bishtin, bishtin ka' t'e ngjinj e ka' vete martonem.

E dhia:

— E ti m'e jep ca bar?

— Ku ka' vete?

— Te fusha.

Vate miu te fusha e i bun:

— Fushë, fushë, fushë... m'e jep ca bar?  
Barin ka' ja jap dhisë, dhia ka' më japje klëmshit, klëmshit ka' ja jap plakës, plaka ka' më japje bishtin, bishtin ka' t'e ngjinj e ka' vete martonem.

E fusha i tha:

— E ti m'e jep ca ujë?

— E ku ka' vete?

— Te kroi.

Miu vate te kroi e i tha:

Krua, krua, krua... m'e jep ca ujë? Ujët ka' ja jap fushës, fusha ka' më japje barin, barin ka' ja jap dhisë, dhia ka' më japje klëmshit, klëmshit ka' ja jap plakës, plaka ka' më japje bishtin, bishtin ka' t'e ngjinj e ka' vete martonem.

E kroi ju përgjegj:

— E ti m'i jep di ve?

— Ku ka' t'i marr?

la coda la devo attaccare e devo andare a sposarmi.

Il prato gli dice:

— E tu me la dai un po' d'acqua?

— Dove posso andare?

— Alla sorgente.

Il topo va alla sorgente e le dice:

— O sorgente, mi dai un po' d'acqua?

L'acqua devo darla al prato, il prato mi deve dare l'erba, l'erba devo darla alla capra, la capra mi deve dare il latte, il latte lo devo dare alla vecchia, la vecchia mi deve dare la coda, la coda la devo attaccare e devo andare a sposarmi.

La sorgente risponde:

— E tu me le dai due uova?

— Dove posso prenderle.

— Dalla gallina.

Il topo va dalla gallina e le dice:

— O gallina, me le puoi dare due uova?

Le uova devo darle alla sorgente, la sorgente mi deve dare l'acqua, l'acqua devo darla al prato, il prato mi deve dare l'erba, l'erba devo darla alla capra, la capra mi deve dare il latte, il latte lo devo dare alla vecchia, la vecchia mi deve dare la coda, la coda la devo attaccare e devo andare a sposarmi.

E la gallina:

— E tu mi dai un po' di mondiglia?

— Dove posso prenderla?

— Al magazzino.



— Te pula.

Miu vate te pula e i thotë:

— Pulë, pulë, pulë... m'i jep di ve, vetë ka' ja jap kroit, kroi ka' më japje ujët, ujët ka' ja jap fushës, fusha ka' më japje barin, barin ka' ja jap dhisë, dhia ka' më japje klëmshit, klëmshit ka' ja jap plakës, plaka ka' më japje bishtin, bishtin ka' t'e ngjinj e ka' vete martonem.


Va al magazzino e gli dice:

— O magazzino mi dai un po' di mondiglia? La mondiglia devo darla alla gallina, la gallina mi deve dare le uova, le uova devo darle alla sorgente, la sorgente mi deve dare l'acqua, l'acqua devo darla al prato, il prato mi deve dare l'erba, l'erba devo darla alla capra, la capra mi deve dare il latte, il latte lo devo dare alla vecchia, la vecchia mi deve dare la coda, la coda la devo attaccare e devo andare a sposarmi.

Mentre stava a parlare al magazzino, entra una gatta e se lo mangia.

Quando la gatta ebbe il topo in pancia si accorse che era senza coda. Lo rimise (lo vomitò) e gli disse:

— Corri a prendere la coda, senza perdere tempo, e poi torna nuovamente qui perché ti devo mangiare!



(\*) Questa favola, inedita, è di uso vivo presso gli Albanesi di Sicilia. Il testo rispecchia la parlata di S. Cristina Gela (PA).

E pula:

— E ti m'i jep di gërdhu?

— Ku ka' t'i marr?

— Te maghaxeni.

Vate te maghaxeni e i thotë:

— Maghaxen, maghaxen, maghaxen... m'i jep di gërdhu? Gërdhutë ka' ja jap pulës, pula ka më japje vetë, vetë ka' ja jap kroit, kroi ka' më japje ujët, ujët ka' ja jap fushës, fusha ka' më japje barin, barin ka' ja jap dhisë, dhia ka' më japje klëmshit, klëmshit ka' ja jap plakës, plaka ka' më japje bishtin, bishtin ka' t'e ngjinj e ka' vete martonem.

Si ish tue i thënë 'shtu maghaxenit, hiri një maçe e e hëngri.

Si maçja e pati te barku u dunâr se ish pa bisht. E volli e i tha:

— Shko e mirr bishtin pa zbjerrë qrò e pra eja pometa htu se ka' të ha!

(\*) Kjo përrallë, që po botohet për herë të parë, është në përdorim të zakonshëm ndër Arbëreshët e Sicilisë. Teksti pasqyron të folmen e Sëndahstinës - Palermo.

## Ali, pascià di Gusia, e Gemal Obria\*

**A**li, pascià di Gusia, quando andò in casa di Gemal Obria, si rese conto che davvero Gemal era uomo saggio. Anche Gemal si accorse che Ali pascià era saggio.

Gli chiese:

— Pascià, quanti anni hai?

— Ho quarant'anni.

— Li possa tu godere per l'avvenire.

Gemal cominciò a stimare Ali Pascià qual giovane saggio e aperto a nuove idee.

A un certo punto Ali pascià gli si rivolse:

— Gemal Agà\*\*, e tu quanti anni hai?

— Ho trecento anni.

— Come trecento anni ?!

— Sì. Cento li ho dal nonno, cento da mio padre e cento sono i miei *(voleva dire che aveva sedimentato in sé usi, tradizioni e virtù dell'albanesità a partire da trecento anni prima ed era in grado di usarli con padronanza nelle varie circostanze)*.

(\*) Da: Anton Çetta, op. cit.

(\*\*) Titolo militare, nell'Impero ottomano, inferiore a pascià, spesso usato in segno di stima.

## Ali Pashë Gusija te Xhemal Obrija\*

**A**li Pashë Gusija, kur pati shkuar te Xhemal Obrija e pa që Xhemali përnjëmend ish njeri i mençëm. Edhe Xhemali vëri re që Ali pasha ish njeri i urtë.

E pyeti:

— Pashë, sa vjet je?

— I kam katërdhjetë vjet.

— Ani, i gëzofsh!

Edhe po i pëlqen Ali pasha Xhemalit si djalë i mençëm e përparimtar.

Dikur iu drejtua Ali pasha atij:

— Xhemal aga — i thotë — sa vjet ke ti?

— I kam treqind vjet.


— Qysh treqind vjet?!

— Po. Njëqind i kam të giyshit, njëqind të babës e njëqind të mitë *(domethënë se që treqind vjet po i trashëgonte doket e zakonet e adetet e shqiptarizmit, edhe paska qenë i zoti t'i përdorë)*.

(\*) Nga: Anton Çetta, v. c.

3<sup>a</sup> Parte

Conoscete  
gli  
albanesi?



## vicini di casa

**L**'Albania si trova nella Penisola Balcanica e le sue coste sono proprio di fronte a quelle della Puglia. La distanza tra Italia e Albania nel Canale di Otranto è di circa 80 km. Vicini di casa dunque. Ma vicini di casa sconosciuti: in Italia si conosce poco o niente di questo paese.

I suoi abitanti sono poco più di 3.000.000 e vivono in un territorio di Kmq. 28.748, occupato in gran parte da montagne. Si tratta di rilievi piuttosto complicati che vanno e vengono per proprio conto, con andamenti irregolari.

A Nord si ergono le Alpi Albanesi con cime sui 2.500 m. e gole selvagge. Ci sono molti laghi, grandi e piccoli, e diverse zone lungo il litorale popolate da una ricca varietà di uccelli acquatici. Tra questi il pellicano. La vegetazione dell'Albania è ricchissima: sul suo territorio crescono 3221 specie di piante, cioè il 30% delle specie vegetali di tutta l'Europa.

## fqinjë

**S**hqipëria gjendet në Gadishullin Ballkanik dhe brigjet e saj janë pikërisht përballë krahinës Pulje të Italisë. Largësia midis Italisë dhe Shqipërisë, te Kanali i Otrantos, është afërsisht prej 80 kilometrash. Gjtonë pra. Por gjtonë të panjohur: në Itali dihet pak ose fare rreth këtij vendi.

Banorët e tij janë një çikë më shumë se 3 milionë dhe jetojnë mbi një hapësirë prej 28.748 kilometrash katrore të përbërë, në pjesën më të madhe, nga male. Fjala vjen për reliev mjaft të ndërlikuar dhe të parregullta, me të ngritura e të ulura.


Në veri ngrihen Alpet e Shqipërisë me maja mbi 2.500 metrash e me gryka të ashpra. Ka edhe shumë liqene, të mëdha e të vogla, dhe disa zona anës bregut të populluara me shumicë nga shpendë uji të ndryshëm. Ndër ta pelikani.

Bimësia e Shqipërisë është shumë e bëgatshme: mbi territorin e saj rriten 3.221 lloje bimësh, domethënë 30% të llojeve vegjetale të mbarë Evropës.

## *il paese delle aquile*

**I**l nome Albania deriva da quello della tribù illirica degli *Albanoi* che si insediò circa cinque secoli a.C. sull'attuale costa albanese.

Gli albanesi antichi chiamavano il loro paese *Arbëria* e se stessi *Arbër/Arbëreshë*, come fanno tutt'oggi gli Albanesi d'Italia e di Grecia, mentre oggi essi lo chiamano *Shqipëria* (che significa probabilmente "terra delle aquile") e chiamano se stessi *Shqiptarë*. Ci sono molte aquile ancora oggi sulle montagne albanesi e l'aquila nera bicipite sta al centro di un rettangolo rosso nella bandiera nazionale.



## *vendi i shqiponjave*

**E**mri Albania rrjedh nga fisi ilir *Albanoi*, i cili u vendos aty nga shekulli i pestë para Krishtit mbi bregdetin shqiptar.

Shqiptarët e lashtë vendin e vet e quanin *Arbëri* dhe vetveten *Arbër/Arbëreshë*, siç ndodh edhe sot tek *Arbëreshët* e Italisë e të Greqisë, kurse sot ata e quajnë *Shqipëri* (që ka gjasa se do të thotë "toka e shqiponjave") dhe vetveten e quajnë *Shqiptarë*. Ka edhe në ditët tona shumë shqiponja mbi malet e Shqipërisë dhe shqiponja e zezë dykrenare spikat tek flamuri kombëtar në qendër të një kënddrejti të kuq.

## gli illiri

**G**li Albanesi sono discendenti degli Illiri che furono i primi abitanti delle coste. Nella lingua albanese *i lir* vuol dire “uomo libero”.

Lo storico latino Tacito descrisse gli antichi Illiri come uomini semplici, frugali, tranquilli, bravissimi a lavorare il ferro e il rame ma pronti, se necessario, a trasformarsi in coraggiosi e fieri guerrieri.

L'essere discendenti degli antichi Illiri è, per gli Albanesi, un motivo di orgoglio ma anche di difesa. I popoli vicini, in particolare i Serbi, hanno sempre cercato di negare questa origine per giustificare le loro invasioni in terra albanese.

## ilirët

**S**hqiptarët janë pasardhës të Ilirëve të cilët kanë qenë banorët e parë e bregdetit.

Në gjuhë shqipe *i lir* do të thotë “njeri që gëzon liri”.

Historiani romak Tacitus ka përshkruar Ilirët e lashtë si njerëz të thjeshtë, të përkorë, të qetë, tejet të aftë për farkëtimin e hekurit e të bakrit, por të gatshëm, po qe nevoja, për t'u shndërruar në luftëtarë trima e krenarë.

Të qenët pasardhës të Ilirëve të lashtë për Shqiptarët është arsye për t'u mburrur por edhe për t'u mbrojtur. Popujt fqinjë, veçanërisht Serbët, kanë kërkuar gjithmonë ta mohojnë këtë prejardhje për t'i arsyetuar dyndyet dhe pushtimet e tyre në tokat shqiptare.

## dalle origini alla dominazione romana

**D**a varie testimonianze archeologiche (armi, ceramiche, utensili) risulta che la terra albanese era già abitata nell'Età della pietra da popolazioni di ignota provenienza che nelle successive età del bronzo e del ferro ebbero rapporti commerciali con popolazioni di analoga civiltà delle sponde adriatiche italiane.

Gli *Illiri*, di origine indo-europea, cominciarono a stanziarsi in Albania intorno al mille a.C. suddividendosi in tribù che vissero a lungo isolate le une dalle altre.

Nel VII secolo a.C. i Greci, interessati ad avere contatti con gli Illiri, già sviluppati sia nella cultura che nel commercio, fondarono sulle coste alcune colonie (fra cui Apollonia, Butrinto, Aulona ed Epidamno, l'attuale Durazzo). Gli Illiri diedero vita, più tardi, nella regione litoranea dell'Epiro (Albania meridionale), ad un regno che si distinse per le sue imprese piratesche nell'Adriatico finché non venne in urto con la potenza di Roma.

## nga origjina deri tek sundumi romak

**N**ga disa dëshmi të ndryshme arkeologjike (armë, qeramikë, vegla) na del se toka shqiptare që nga Koha e gurit ka qenë e banuar nga popullsi me prejardhje të panjohur të cilat në kohët pasuese të bronzit e të hekurit ishin në marrëdhënie me popullata të qytetërimeve të ngjashme të bregdetit adriatik të Italisë.


*Ilirët*, me origjinë indoevropjane, filluan të vendosen ne Shqipëri aty nga fillimi i mijëvjeçarit të parë të epokës së vjetër, duke u nëndarë në fise që jetuan për një kohë të gjatë të veçuara.

Në shekullin e shatatë para Krishtit, Grekët, të interesuar për marrëdhënie me Ilirët, tashmë të zhvilluar si për kulturë ashtu edhe për tregti, themeluan anës detit disa koloni (ndër to Apolonin, Butrintin, Aulonin, Epidamnin-Durrësin e sotëm).

Më vonë Ilirët, në krahinën bregdetare të Epirit (Shqipëri jugore) krijuan një mbretëri e cila u dallua për vepra kusarie

Dopo una fiera resistenza le tribù illiriche vennero sbaragliate dai Romani nel 168 a.C. e l'Iliria fu incorporata nella Provincia della Macedonia. Una sola tribù, quella degli Albanoi, nell'odierno territorio di Tirana, riuscì a conservare una certa autonomia.

Fra le strade costruite dai Romani, importantissima fu la *Via Aegnatia* che, continuando al di là del mare la *Via Appia*, da Durazzo, attraverso la Penisola Balcanica, portava a Tessalonica (Salonicco) e da qui a Bisanzio (Costantinopoli).



në Adriatik deri që ra në ndeshje me fuqinë e Romës. Pas një qëndrimi krenar, fiset ilire u shpartalluan nga Romakët më 168 p.K. dhe Iliria u përfshi në Provincën e Maqedonisë. Një fis i vetëm, i Albanoi-ve, në territorin e sotëm të Tiranës, arriti ta gëzonte njëfarë autonomie.

Midis rrugëve të ndërtuara nga Romakët, tejet e rëndësishme paska qenë *via Egnatia* e cila, duke vazhduar përtej detit *via Apja-n*, prej Durrësi e përmes Gadishullit Ballkanik shpiente në Selanik e prej atje deri në Bizant (Kostantinopojë-Stamboll).



## i turchi

**C**on la divisione amministrativa dell'Impero Romano in "Occidentale" e "Orientale", l'Albania rimase nell'area orientale come provincia a sé, col nome di *Praevalitana*, e quindi inserita nella *diocesi V delle Mesie*.

All'Impero bizantino e alla Chiesa orientale diede uomini di primo piano come Giustiniano.

Poi, a ondate successive, arrivarono da invasori i Barbari, i Bulgari, i Normanni, i Crociati, i Serbi ... i Turchi.

Per resistere soprattutto ai Serbi, i quali avevano organizzato una chiesa nazionale e la usavano come elemento di colonizzazione, gli albanesi del nord passarono alla Chiesa romana.

Dall'epoca bizantina a quella turca Venezia fu costantemente presente, principalmente nella zona costiera.

La dominazione turca, durata cinque secoli, dal 1400 al 1900, impose la religione e i costumi islamici in gran parte del paese.

## turqit

**M**e ndarjen administrative e Perandorisë Romake në "Perëndimore" dhe "Lindore", Shqipëria u përfshi në sferën lindore, si provincë më vete me emër *Paevalitana*, duke hyrë në *dioqezën e pestë të Mesieve*.

Perandorisë së Bizantit e Kishës lindore u dha burra të dorës së parë (Justiniani, ...).

Pastaj, me vala njëra pas tjetrës, mbërritën si pushtues Barbarët, Bullgarët, Normanët, Kryqëzatësit, Serbët... Turqit.

Për të përballuar Serbët, të cilët kishin themeluar një kishë kombëtare më vete dhe e përdornin si mjet kolonizimi, shqiptarët e veriut kaluan në Kishën katolike.


Që nga koha bizantine e deri tek e osmanllive zgjati edhe prania e Venedikut, sidomos nëpër vendet bregdetare.

Sundimi turk, që zgjati pesë shekuj, prej 1400 deri më 1900, vendosi fenë dhe zakonet islame te pjesa më e madhe e vendit.

Gli stessi nobili albanesi divennero *bey* e *pascià*, titoli dati dal sultano ottomano.

Tuttavia, soprattutto nelle montagne del nord, le tribù riuscirono a conservare le antiche tradizioni attraverso il diritto consuetudinario (*kanùn* di Lek Dukagjini) e il cristianesimo cattolico al nord, ortodosso al sud.

L'indipendenza arrivò nel 1912, proclamata a Valona il 28 novembre da Ismail Kemal bey Vlora e quindi ratificata a Londra. Il paese, tuttavia, continuò ad essere dominato da alcuni feudatari e la gente viveva nella miseria. Dopo la prima guerra mondiale all'Italia fu dato il ruolo di *protettore* del nascente stato albanese.



Vetë bujarët shqiptarë qenkanë shndërruar në *bejlerë* e *pashallarë*, ofiqe që iu falën nga sulltani.

Megjithatë, sidomos në malësitë e veriut, fiset arritën t'i ruajnë traditat e lashta nëpërmjet të së drejtës zakonore (Kanuni i Lekë Dukagjinit) dhe të fesë së krishtere: katolike në veri, ortodokse në jug.

Pavarësia erdhi më 1912: e shpallur në Vlorë me 28 nëntor nga Ismail Kemal Bey Vlora, më vonë u miratua në Londër. Sidoqoftë mbi vendin vazhdoi sundimi i disa çifligarëve të mëdhenj dhe gjindja jetonte në skamje. Mbas luftës së parë botërore Italisë iu dha roli *mbrojtës* ndaj të porsalindurit shtet shqiptar.



## ***l'Italia invade l'Albania***

**I**l nuovo stato indipendente fu retto per meno di un anno da un re, scelto, secondo l'uso dell'epoca, tra i principi tedeschi.

Quindi si ebbe un periodo di democrazia, sotto la guida del vescovo Theofan Stilian Noli (capo del Governo, fondatore della *Chiesa Ortodossa Autocefala Albanese*, poeta, letterato, traduttore poliglotta).

Ma l'albanese Ahmet Zogu, già alto ufficiale austro-ungarico, riuscì a prendere il potere come presidente della Repubblica, in ciò aiutato dalla Jugoslavia.

Con l'appoggio del governo italiano (fascista), egli fu poi proclamato re con il nome di *Zog I*.

Nel 1939 il fascismo, temendo che l'Albania sfuggisse al controllo italiano, occupò rapidamente tutto il paese e la corona passò a Vittorio Emanuele III, re d'Italia.

## ***Italia pusthon Shqipërinë***

**S**hteti i ri i pavarur u udhëhoq për më pak se një viti nga një mbret të zgjedhur, sipas doket e kohës, ndër princërit gjermanë.

Më vonë u pat një kohë me demokraci, nën udhëheqen e dhespotit Fan Nolit (shef i *Qeverisë*, themelues i *Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare*, poet, shkrimtar, përkthyes poliglot).

Por shqiptari Ahmet Zogu, ish-oficer i lart i Austro-Ungarisë, me ndihmën e Jugosllavisë, arriti ta merrte pushtetin si kryetar i Republikës.

Me mbështetjen e qeverisë italiane (fashiste), pastaj ai u shpall mbret me emër *Zogu i Parë*.

Më 1939 fashizmi, nga frika se Shqipëria mos t'i ikte kontrollit italian, pushtoi me shpejtësi tërë vendin dhe kurora kaloi tek Viktori Emanueli i Tretë, mbreti i Italisë.

Shqipëria aso kohe ishte në gjendje shumë të keqe (90% analfabetë, gjatësia mesatare e jetës 38 vjet).

L'Albania era in condizioni disastrose (90% di analfabeti, durata media della vita 38 anni).

Il periodo italiano fu caratterizzato dall'unità territoriale e amministrativa delle terre albanesi (Albania e Kosovo) e dall'apertura delle scuole in lingua albanese. Si fecero anche i primi passi nell'industria e si dette impulso agli studi albanologici.

Tuttavia il fascismo era ispirato da principi colonialisti e usò l'Albania come base per l'invasione della Grecia.

Nel 1946, dopo aver subito una pesante occupazione tedesca e una guerra civile tra i seguaci del comunismo e il Fronte Nazionale, l'Albania diventò Repubblica Popolare (comunista), guidata fino al 1985, anno della sua morte, da *zio Enver* (come lo chiamano eufemisticamente i rifugiati), il dittatore Enver Hoxha (pronuncia: Oggia).

Nel 1991 la statua di *zio Enver* fu abbattuta dai dimostranti nella piazza di Tirana al grido di «Democrazia, democrazia!».

Sempre nel 1991 si sono tenute le prime libere elezioni e nell'aprile di quest'anno è stato eletto il nuovo presidente della Repubblica.

Periodi italiani e kanë karakterizuar njësimi territorial e administrativ i tokave shqiptare (Shqipëri e Kosovë) si edhe hapja e shkollave në gjuhë shqipe.

U bënë po ashtu hapat e parë në industri dhe morën hov studimet albanologjike. Sidoqoftë fashizmi nisej nga parime kolonialiste dhe Shqipërinë e përdori si bazë për të kaluar në Greqi.

Më 1946, pasi pësoi një shkelje të rëndë nga gjermanët dhe një luftë të brendshme midis ithtarëve të komunizmit e të Ballit Kombëtar, Shqipëria u shpall Republikë Popullore (komuniste), udhëhequr deri më 1985, kur vdiq, nga *xhaxhi Enver* (siç e quajnë, me eufemizëm refugjatët shqiptarë), d. m. th. diktatori Enver Hoxha.

Më 1991 truporja e madhe e *xhaxhit Enver*, tek sheshi i Tiranës, u përmbys nga demonstruesit me britmën: «Demokraci, demokraci!».

Po asthu më 1991 u mbajtën për herë të parë zgjedhje të lira, dhe në prillin e sivjetshëm u zgjodh kryetari i ri i Republikës.

## le comunità italo-albanesi

**O**ggi nel mondo vivono circa sette milioni di albanesi etnici. Tre milioni abitano dentro i confini della Repubblica albanese, altri tre milioni nell'ex Jugoslavia (Kosovo, Macedonia, Montenegro, Serbia): il loro nome è *shqiptarë*; un altro milione circa di albanesi vive in diaspora.

In questa "diaspora", agli Albanesi d'Italia (*Arbëreshë*) — distribuiti in 50 centri, nelle sette regioni del meridione, dall'Abruzzo alla Sicilia — spetta un posto particolare. Questo sia per il modo in cui



Palazzo Adriano - Palermo

## kolonitë arbëreshe

**N**ë botë jetojnë sot afro shtatë milionë njerëz me perkatësi kombëtare shqiptare. Tremilionë jetojnë brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë, tremilionë tjerë në ish-Jugosllavinë (Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi): ata quhen *Shqiptarë*.

Njëmilion të tjerë jetojnë në diasporë. Në këtë diasporë, Shqiptarëve të Italisë (*Arbëreshët*) — të shpërndarë në 50 qendra banimi nëpër shtatë krahinat e jugut, që nga Abruci e deri në Sicili — u takon një vend i veçantë, qoftë për menyrën se si i kanë ruajtur gjuhën, doket e zakonet e stërgjyshave, qoftë edhe për institucionet, sidomos kulturoro-fetare, e për veprimtaritë me anë të të cilave e mbajnë gjallë liturgjinë e Kishës Lindore dhe i thellojnë studimet mbi atdheun e të parëve dhe mbi komunitetet *arbëreshe*, ndonëse me shumicë — ndoshta gjysma — kanë pësuar një proces të pashmagshëm italianizimi. Emigrimet historike të shqiptarëve në Itali janë bërë aty nga '400

hanno saputo conservare la loro lingua, gli usi e i costumi degli avi, sia per le istituzioni, soprattutto religiose e culturali, e le attività con cui mantengono viva la liturgia orientale e approfondiscono gli studi sul paese d'origine e sulle comunità *arbëreshe*, anche se molti — circa metà — hanno subito un inevitabile processo di italianizzazione.



